



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1476/22

GJYKATA KOMERCIALE-Dhoma e Shkallës së Dytë,në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit/paditësit me seli në adresën Atlanta, Georgia Usa me përfaqësues Y.S.P, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Agron Selimaj avokat nga Prishtina, ndaj kundërshtarit të sigurimit/paditurit me emër tregtar me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat Liman Musa nga Ferizaj duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit të sigurimit e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.189/22 i datës 11/05/2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13/09/2022, mori këtë:

AKTVENDIM

APROVOHET ankesa e propozuesit/paditësit me seli në adresën, Georgia Usa me përfaqësues Y.S.P, **ANULOHET** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike, I.EK.nr.189/22 e datës 11/05/2022, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale Dhomës së Shkallës Parë parë në rishqyrtim dhe rivendosje .

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor I.EK.nr.189/22 e datës 11/05/2022, ka vendosur që të refuzon propozimin e propozuesit të masës së sigurisë me seli në adresën Georgia Usa me përfaqësues Y.S.P, i paraqitur kundër kundërshtarit të sigurimit me emër tregtar me seli në Ferizaj ashtu që në dispozitivin e aktvendimit vendos që të refuzohet propozimi i propozuesit që të detyrohet kundërshtari i sigurimit që të ndërpresë të gjitha veprimet që shkelin të drejtën e propozuesit në mbrojtje të markave tregtare të regjistruara në Republikën e Kosovës, që ti ndalohet kundërshtarit të sigurimit cdo aktivitet që do të shkelte të drejtën e propozuesit sipas vendimit KS/2021/611-, të datës 28.10.2021, vendimit numër KS/2021/5875, të datës 07.10.2021 dhe vendimit nr. 5901-1/2013 të datës 23.02.2013, në vecanti importimi, eksportimi dhe vendosja në tregun e Kosovës të produkteve që përbëjnë shkeljen e markës tregtare të propozuesit të masës së sigurimit ,të

urdhërohet kundërshtari i sigurimit që ti ofroj propozuesit të masës së përkohshme të sigurisë në disponim kopjet e deklaratave Unike Doganore (DUD) për produktet e importuara pa autorizim/pëlqimin e bartësit të markës tregtare, për tri vitet e fundit, dhe, që tentojnë të futen apo që ndodhen kundërligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës pa autorizim/pëlqim të paditësit dhe bartësit të së drejtës së markës tregtare, të urdhërohet Inspektorati për Mbikqyrjen e Tregut që ti konfiskoj dhe largoj nga tregu i Republikës së Kosovës të gjitha produktet,,, të importuara nga kundërshtari i sigurimit dhe Shoqëri të pa autorizuar tregtare dhe pa autorizim të bartësit të së drejtës së markës së regjistruar tregtare si dhe të detyrohet i padituri, Dogana e Kosovës dhe Inspektorati për Mbikqyrjen e Tregut pranë MTI, që të zbatojnë këtë masë të përkohshme të sigurisë deri në vendosjen meritore dhe të formës së plotfuqishme të kësaj çështje gjyqësore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale dhe të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar ndërsa aktvendimi i atakuar të priset.

Kundërpropozuesi ka paraqitur përgjigje në ankesë me të cilën ka propozuar që të refuzohet ankesa e propozuesit dhe të vërtetohet aktvendimi atakuar.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja-propozuesja e sigurimit me seli në adresën, Georgia Usa me përfaqësues Y.S.P, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare, me propozim për caktimin e masës së sigurisë .

Gjykata e shkallës së parë lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë ka mbajtur seancën dëgjimore dhe ndërgjyqësit i kanë paraqitur pretendimet e tyre sa i përket bazueshmërisë së propozimit dhe pas përfundimit të seancës gjyqësore, ka marr aktvendimin e ankimit duke u bazuar në dispozitën e nenit 297 par.1 të LPK-së dhe duke e arsyetuar aktvendimin e ankimit se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë sipas detyrës zyrtare, e në bazë të nenit 194 të LPK, e vlerëson aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë brenda kufijve të shkaqeve ankimore të theksuara në ankesë, duke i vështruar sipas detyrës zyrtare shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 nën pikën b), g), j), k) dhe m) të këtij ligji dhe aplikimin e drejtë të së drejtës materiale.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka gjetur se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183 par.1 të LPK-së , për arsye se ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt

vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare, andaj aktvendimi i ankimuar doemos është dashur të priset.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, me një kujdes të shtuar i ka analizuar edhe pretendimet tjera ankimore në raport me provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe erdh në përfundim se këto pretendime janë të bazuara se sepse titullari i markës tregtare mund t'i ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njejtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke tregtare, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare. Andaj, përdorimi i paautorizuar i një marke tregtare si e drejtë ekskluzive e pronarit të saj sipas nenit 8 të Ligjit mbi Markat Tregtare përmban shkelje të markës tregtare.

Kjo gjykatë vlerëson se shkelja mund të bëhet me cdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, përkatësisht kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar.

Me nenin 101 të LMT-së, i jep të drejtë bartësit të së drejtës nga marka tregtare që në rastin e shkeljeve të kryera në veprimtari afariste, nëse dëshmon se shkelja është kryer me qëllim të përfitimit material, jo vetëm kur dëshmon se marka e tij është shkelur, por edhe në rast se dëshmon se marka e tij kërcënohet të shkelet respektivisht personi tjetër është duke tentuar ta shkel markën e tij. Sipas nenit 101 të LMT-së, gjykata mund të caktoj ndonjëherë prej masave: të urdhërojë shkelësin e supozuar që t'i ndalojë dhe të i ndërpresë veprimet që shkelin markën tregtare: të lëshojë një urdhër ndalimi kundër ndërmjetësuesit shërbimet e të cilit i përdorin personat e tretë që shkelin markën tregtare: të urdhërojë konfiskimin apo largimin e produkteve që pa të drejtë emërtohen si marka tregtare.

Sipas nenit 8 të Ligjit për Markat Tregtare, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen si të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullari i markës tregtare mund ti ndaloj palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjën identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet e llojit të njejtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke tregtare të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur apo kanë mundur të kenë ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në ri-procedurë t'i evitoj të gjitha të metat të cekura më lartë, t'i vërtetoi faktet relevante të sipërpërmendura, t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme për të vlerësuar bazueshmërinë e kundërshtimeve të palëve, ashtu që pastaj, të vendos drejt dhe sipas Ligjit.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1476/22, data 12.09.2022

Kryetarja e kolegjit-Gjyqtarja
Saranda Bogaj Sheremeti